<p style="text-align: center;">Neni 46 Shkëmbimi i informatave</p> <p>1. Të dhënat nga Sistemi Informativ për Ajër, për pikat e matjes nga neni 13 paragrafi 5 të këtij ligji përdoren për shkëmbimin e informatave, për të dhënat nga rrjeti për monitorimin e cilësisë së ajrit si dhe të dhënat për rrjetin, stacionet dhe teknikave të matjes si dhe për raportimin vjetor për vlerësimin e cilësisë së ajrit.</p> <p>2. Të dhënat nga Sistemi Informativ për Ajër, të mbledhura në formën e duhur</p>	<p style="text-align: center;">Article 46 Exchange of information</p> <p>1. The data from the Air Information System, for the measuring points from Article 13 paragraph 5 of this law, are used for the exchange of information, for the data from the network for air quality monitoring and the data for the network, stations and techniques of measurement, as well as for annual reporting on air quality assessment.</p> <p>2. Data from the Air Information System, collected in the appropriate form, are used to</p>	<p style="text-align: center;">Član 46 Razmena informacija</p> <p>1. Podatci iz Informacionog Sistema za Vazduh o mestima meranjima iz člana 13., stavka 5. ovog zakona služe za razmenu informacija, o podacima iz mreže za praćenje kvaliteta vazduha i o podacima o mreži, stanicama i tehnikama merenja kao i za godišnji izveštaj za procenu kvaliteta vazduha.</p> <p>2. Podatci iz Informacionog Sistema za Vazduh, prikupljeni na odgovarajućoj formi</p>

<p>përdoren për ofrimin e informatave për planet nga neni 27 të këtij ligji si dhe të dhënat për emisionet nga burimet e ndotjes së ajrit, për nevojat e raportimit, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.</p> <p>3. Ministria përcakton me akt nënligjor mënyrën, afatet, përmbajtja dhe formati i shkëmbimit të dhënave nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Qasja në informata</p> <p>1. Ministria siguron qasjen në informata dhe shkëmbimin e të dhënave për cilësinë e ajrit në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.</p> <p>2. Për nevojat e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të përputhshmërisë me vlerat kufitare dhe niveleve kritike si dhe për arritjen e vlerave të synuara, të dhënat të cilat i prezantohen Komisionit Evropian dhe Agjencionit Evropian për Mjedis, përfshinë:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. ndryshimet të cilat janë bërë për atë vit, në kufi të zonave dhe aglomerateve;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. regjistrin e zonave dhe aglomerateve në të cilat niveli i një ose më tepër ndotësve është më i lartë se vlerat kufitare</p>	<p>provide information on plans from Article 27 of this law, as well as data on emissions from air pollution sources, for reporting needs, according to international agreements.</p> <p>3. The manner, deadlines, content and format of data exchange from paragraph 1 and 2 of this Article, are determined by the Ministry with a sub-legal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Access to information</p> <p>1. The Ministry ensures access to information and exchange of data on air quality, in accordance with paragraph 3 of this article.</p> <p>2. For the needs of the assessment of conditions compliance with the limit values and critical levels, as well as for the achievement of the target values, the data presented to the European Commission and the European Environment Agency, should include:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. changes which have been made for that year, at the boundaries of zones and agglomerations;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. register of zones and agglomerations in which the level of one or more pollutants is higher than the limit values and the tolerance</p>	<p>upotrebljavaju se za pružanje informacija o planovima iz člana 27. ovog Zakona kao i podatcima o emisijama iz izvora zagađenja vazduha, za potrebe izveštavanja shodno međunarodnim sporazumima.</p> <p>3. Način, rokovi, sadržaji i format razmene podataka iz stavke 1. i 2. ovog člana uređuje Ministar sa posebnim podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;">Član 47 Dostupnost na informacije</p> <p>1. Ministarstvo obezbeđuje dostupnost na informacije i razmenu podataka o kvalitetu vazduha u skladu sa članom 47 stavka 3, ovog Zakona.</p> <p>2. Za potrebe procene ispunjavanja uslova sukladnosti sa graničnim vrednostima i kritičnim razinama kao i postignuća ciljanih vrednosti, podatci koji se dostavljaju Evropskoj Komisiji Evropskoj Agenciji za Životnu Sredinu uključuju:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. promene koje su vršene te godine, na granici zona i aglomeracija;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. popis zona i aglomeracija u kojima su nivo jednog ili više zagađivača viši od graničnih vrednosti i granice tolerancije,</p>
---	--	---

<p>dhe kufiri i tolerancës ku është i ndryshueshëm, ose janë më të larta se vlerat e synuara ose vlerat kritike dhe për ato zona dhe aglomerate;</p> <p>2.3. nivelet e ndotësve të ajrit dhe nëse është relevante, datat dhe periudhat për të cilat i referohen këto nivele;</p> <p>2.4. vlerësimin e ndotjeve nga burimet natyrore dhe vlerësimin e grimcave fluturuese të ri-suspenduara pas hedhjes së rërës dhe kripës në sezonin dimëror dhe vlerësimin e niveleve, nëse është e nevojshme.</p> <p>3. Të gjitha të dhënat e matjeve nga stacionet monitoruese, në formatin burimor dhe valid dhe shpeshhtësisë së matjeve, duhet të jenë në disponim për institucionet e nivelit qendror dhe lokal, personat juridik të autorizuar për monitorimin e cilësisë së ajrit, menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe hartimin të planeve për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.</p> <p>4. Në zonat dhe aglomeratet në të cilat vjen deri te tejkalimi i vlerës kufitare ose vlerës së synuar, me qëllim të procedurave të mëtejme, sigurohen të dhënat si në vijim:</p> <p>4.1. regjistri i zonave dhe aglomerateve;</p>	<p>limit where it is variable, or are higher than the target values or critical values for those areas and agglomerations;</p> <p>2.3. levels of air pollutants and, if relevant, the dates and periods to which these levels refer;</p> <p>2.4. assessment of pollution from natural sources and assessment of re-suspended flying particles after sand and salt dumping in the winter season and assessment of levels, if necessary.</p> <p>3. All measurement data from monitoring stations, in source and valid format and frequency of measurements, should be available to central and local level institutions, legal entities authorized to monitor air quality, air quality management and drafting plans for protection and improvement of air quality.</p> <p>4. In the zones and agglomerations in which the limit value or the target value is exceeded, for the purpose of further procedures, the following data are provided:</p> <p>4.1. register of zones and agglomerations;</p>	<p>gde je promenljivo, ili su viši od ciljanih vrednosti ili kritičnih razina, i za te zone i aglomeracije:</p> <p>2.3. nivo zagađivača vazduha i, ako je relevantno, datumi i periodi na koje se ti nivoi odnose;</p> <p>2.4. procenu zagađenja iz prirodnih izvora i pocenu resuspenzije lebdećih čestica nakon zimskog posipavanja puteva peskom ili solju u zimskoj sezoni i procenu nivoa, ako je potrebno.</p> <p>3. Svi podatci merenja iz stanica za praćenje, u izvornom i validiranom formatu i gustoći merenja, moraju biti dostupni za tela centralne i lokalne uprave, pravna lica ovlašćena za poslove praćenja kvaliteta vazduha, poslove upravljanja kvalitetom vazduha i izrade planova za zaštitu i poboljšavanje kvaliteta vazduha.</p> <p>4. U zonama i aglomeracijama u kojima dolazi do prekoračenja granične vrednosti ili ciljane vrednosti, radi daljnjih postupaka, osiguravaju se sledeći podaci:</p> <p>4.1. registar zona i aglomeracija;</p>
--	---	--

<p>4.2. regjistri i zonave në të cilat janë tejkaluuar vlerat kufitare të synuara;</p> <p>4.3. vlerat e përqendrimeve të vlerësuar;</p> <p>4.4. shkaqet e tejkalimeve të vlerave kufitare të synuara, e posaçërisht burimet të cilat i kontribuojnë kësaj;</p> <p>4.5. përqindja e popullatës së ekspozuar nga vlerat e rritura.</p> <p>5. Të dhënat nga paragrafi 2 dhe 4 të këtij neni i siguron AMMK dhe ia paraqet Agjencionit Evropian për Mjedis, sipas planifikimit kohor të raportimit për këto të dhëna.</p>	<p>4.2. register of areas in which the target limit values have been exceeded;</p> <p>4.3. values of estimated concentrations;</p> <p>4.4. the causes of exceeding the target limit values, especially the resources that contribute to this;</p> <p>4.5. percentage of the population exposed to increased values.</p> <p>5. The data from paragraph 2 and 4 of this Article are provided by KEPA and must be submitted to the European Environment Agency, according to the reporting schedule for reporting these data.</p>	<p>4.2. registar zona u kojima su ciljane granične vrednosti prekoračene;</p> <p>4.3. vrednosti procenjenih koncentracija;</p> <p>4.4. razlozi prekoračenja ciljanih graničnih vrednosti, posebno izvori koji tome doprinose;</p> <p>4.5. postotak stanovništva izloženo povišenim vrednostima.</p> <p>5. Podatke iz stavke 2. i 4. ovoga članka osigurava AZZSK, i te podatke dostavlja Europskoj Agenciji, prema planu izveštavanja za ove podatke.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 48 Raporti vjetor për cilësinë e ajrit</p>	<p style="text-align: center;">Article 48 Annual air quality report</p>	<p style="text-align: center;">Član 48 Godišnji izveštaj o kvalitetu vazduha</p>
<p>1. Raportin vjetor për cilësinë e ajrit në Republikën e Kosovës e harton AMMK deri më 31 Qershor të vitit vijues për vitin e kaluar kalendarik.</p> <p>2. Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni hartohet në bazë të aktit nënligjor të përcaktuar në nenin 12 paragrafi 1 të këtij ligji dhe përmban: pasqyrën e nivelit të ndotësve në ajër të cilët tejkalojnë vlerën kufitare, vlerën e synuar, objektivat afatgjate, pragun e informimit dhe pragun e paralajmërimit, për</p>	<p>1. The annual report on air quality in the Republic of Kosovo is compiled by KEPA by June 31 of the current year for the previous calendar year.</p> <p>2. The report from paragraph 1 of this Article, is drafted based on the sub-legal act defined in article 12 paragraph 1 of this law and contains: overview of the level of air pollutants which exceed the limit value, target value, long-term objectives, information threshold and the warning threshold, for the set time and all the</p>	<p>1. Godišnji izveštaj o kvalitetu vazduha u Republici Kosovo izrađuje AZZSK do 31 Juna tekuće godine za prethodnu kalendarsku godinu.</p> <p>2. Izveštaj iz stavke 1. ovog člana se izrađuje na osnovu podzakonskog akta uređenog u članu 12. stavka 1. ovog Zakona i sadrži: pregled nivoa zagađivača na vazduhu koje prekoračuju graničnu vrednost, ciljanu vrednost, dugoročne ciljeve, prag informiranja i prag upozorenja, za određeno</p>

<p>kohën e caktuar dhe të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara në nenin 47 paragrafi 2 dhe 4 të këtij ligji. Këto të dhëna ndërlidhen me vlerësimin përmbledhës të efekteve të këtyre tejkalimeve, në shëndetin e njeriut dhe vegetacion.</p>	<p>necessary data defined in article 47 paragraph 2 and 4 of this law. These data relate to the summary assessment of the effects of these exceedances on human health and vegetation.</p>	<p>vreme i sve potrebne podatke utvredene članom 47., stavke 2. i 4. ovog Zakona. Ovi podatci vezane sa sveukupnom procenom efekata ovih prekoračenja na ljudsko zdravlje i vegetaciju.</p>
<p>KAPITULLI XI FINANCIMI PËR MBROJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË AJRIT DHE INSTRUMENTET EKONOMIKE</p>	<p>CHAPTER XI FINANCING FOR PROTECTION AND IMPROVEMENT OF AIR QUALITY AND ECONOMIC INSTRUMENTS</p>	<p>POGLAVLJE XI FINANCIRANJE ZAŠTITE I POBOLJŠANJA KVALITETA VAZDUHA I EKONOMSKI INSTRUMENTI</p>
<p>Neni 49 Financimi për mbrojtjen e ajrit nga ndotja</p>	<p>Article 49 Funding for air protection from pollution</p>	<p>Član 49 Financiranje za zaštitu vazduha od zagađenja</p>
<p>1. Mjetet financiare për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen e shtresës së ozonit, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, Buxheti i Komunës, si dhe burimeve të tjera financiare, sipas dispozitave të këtij ligji.</p> <p>2. Mjetet nga paragrafi 1 të këtij neni përdoren për financimin e:</p> <p>2.1. SMCA-së;</p> <p>2.2. stacioneve matëse dhe matjeve për qëllime të veçanta, në nivel lokal;</p>	<p>1. Financial means for the protection and improvement of air quality and protection of the ozone layer, are provided from the Budget of the Republic of Kosovo, the Budget of the Municipality, as well as other financial sources, according to the provisions of this law.</p> <p>2. The funds from paragraph 1 of this Article are used for financing as follows:</p> <p>2.1. AQMS;</p> <p>2.2. measuring and metering stations for special purposes, at the local level;</p>	<p>1. Finansijska sredstva za zaštitu i poboljšanje kvaliteta vazduha, zaštitu ozonskog omotača obezbeđuju se iz budžeta Republike Kosovo, budžeta opštine, kao i iz drugih finansijskih izvora, prema odredbama ovog zakona.</p> <p>2. Sredstva iz stavke 1. ovog člana koriste se za financiranje:</p> <p>2.1. SPKV;</p> <p>2.2. mernih stanica i merenja za posebne svrhe, na lokalnom nivou;</p>

<p>2.3. hartimin e programeve të matjeve për qëllime të veçanta;</p> <p>2.4. masave për mbrojtjen e popullatës gjatë shfaqjes së pragjeve të alarmit;</p> <p>2.5. hartimit dhe zbatimit të planeve të veprimit, përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe planeve afatshkurta të veprimit;</p> <p>2.6. masave dhe programeve për mbrojtjen e shtresës së ozonit;</p> <p>2.7. kërkimeve profesionale dhe shkencore, të nevojshme për realizimin e qëllimeve të këtij ligji;</p> <p>2.8. inkurajimit për përdorimin e makinave të pranueshme ekologjike.</p> <p>3. Burime tjera financiare të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë: burimet e ndotësve, grantet, kredit, fondet mbështetëse të Qeverisë, fondet e ndihmës ndërkombëtare, fondet e investimeve të huaja të destinuara për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe shtresës së ozonit.</p> <p>KREU XII MBIKQYRJA INSPEKUESE</p> <p>Neni 50 Mbikëqyrja inspektuese</p>	<p>2.3. designing measurement programs for special purposes;</p> <p>2.4. measures to protect the population during the emergence of alarm thresholds;</p> <p>2.5. drafting and implementing action plans, for improving air quality and short-term action plans;</p> <p>2.6. measures and programs for the protection of the ozone layer;</p> <p>2.7. professional and scientific research, necessary for the realization of the purposes of this law;</p> <p>2.8. encouraging the use of environmentally acceptable/ friendly vehicles.</p> <p>3. Other financial resources referred to in paragraph 1 of this Article are: pollutant sources, grants, loans, Government support funds, international aid funds, foreign investment funds intended to protect and improve air quality and the ozone layer.</p> <p>CHAPTER XII INSPECTION SUPERVISION</p> <p>Article 50 Inspection supervision</p>	<p>2.3. izrade programa merenja za posebne svrhe;</p> <p>2.4. mera za zaštitu stanovništva pri pojavi pragova upozorenja;</p> <p>2.5. izradi i sprovođenju akcionih planova, poboljšanja kvaliteta vazduha i kratkoročnih akcionih planova;</p> <p>2.6. mera i programa za zaštitu ozonskog sloja;</p> <p>2.7. stručnih i naučnih istraživanja, potrebnih za ostvarivanje ciljeva ovog Zakona;</p> <p>2.8. podsticanja za korišćenje ekoloških prihvatljivih vozila.</p> <p>3. Drugi izvori iz stavke 1. ovoga člana su: izvori zagađivača, grantovi, zajmovi, sredstva Vladine podrške, sredstva međunarodne pomoći, sredstva stranih ulaganja namenjenih za zaštitu i poboljšanje kvaliteta vazduha i ozonskog omotača.</p> <p>POGLAVLJE XII INSPEKCIJSKI NADZOR</p> <p>Član 50 Administrativni nadzor</p>
--	--	--

<p>1. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji si dhe akteve nënligjore të nxjerra prej tij, kushtet dhe metodën e punës së subjekteve të mbikëqyrur si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj e bënë Inspektori mjedisor i Ministrisë.</p> <p>2. Mbikëqyrjen inspektuese për Lejen Mjedisore Komunale e kryen Inspektori mjedisor i Komunës.</p> <p>3. Ministria mundet me autorizim të veçantë, të autorizoj Inspektorin mjedisor të Komunës për kryerjen e detyrave tjera.</p> <p>4. Punët e Inspektorit mjedisor mund t'i kryej edhe zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon Ministria, gjegjësisht Komuna.</p>	<p>1. The inspection supervision for the implementation of this law as well as the sub-legal acts issued by it, the conditions and method of work of the supervised entities as well as the measures for environmental protection defined by this law, are made by the Environmental Inspector of the Ministry.</p> <p>2. Inspection supervision for the Municipal Environmental Permit is performed by the Municipal Environmental Inspector.</p> <p>3. The Ministry may, by the special authorization, authorize the Environmental Inspector of the Municipality to perform other duties.</p> <p>4. The work of the environmental inspector can be performed by another official of environmental protection who is authorized by the Ministry, respectively the Municipality.</p>	<p>1. Administrativni nadzor za primenu ovog Zakona i podzakonskih akata donesenih na temelju njega, uslove i nacin rada subjekata kao i mere za zaštitu životne sredine propisanim ovim zakonom vrši Inspektorata za zaštitu životne sredine Ministarstva.</p> <p>2. Inspekcijiski nadzor za Opštinsku Dozvolu Životne Sredine vrsi Opštinski Inspektor životne sredine.</p> <p>3. Ministarstvo može sa posebnim ovlasenjem ovlastiti Opštinskog Inspektora životne sredine za izvršenje ostalih zadataka.</p> <p>4. Zadatke Insoektora za zastitu zivotne sredine može izvršiti i drugi sluzbenik za zastitu zivotne sredine kojeg ovlasti Ministarstvo, odnosno Opština.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 51 Subjektet e mbikëqyrura në procedurë të inspektimit</p> <p>1. Subjektet e mbikëqyrura në tekstin e mëtejme (personi i mbikëqyrur) në procedurën e inspektimit lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe akteve tjera nënligjore të nxjerra nga ky ligj janë:</p>	<p style="text-align: center;">Article 51 Supervised entities in the inspection procedure</p> <p>1. The supervised entities (hereinafter the supervised person) in the inspection procedure related to the implementation of this law and other sub-legal acts issued by this law are as following:</p>	<p style="text-align: center;">Član 51 Nadzirani subjekti u postupku inspekcije</p> <p>1. Subjekti nadgledani u sledećem tekstu (nadzirano lice) u inspekcijskom postupku u vezi sa primenom ovog zakona i drugih podzakonskih akata donetih ovim zakonom su:</p>

<p>1.1. ndotësi;</p> <p>1.2. personi juridik i cili kryen veprimtarinë e monitorimit të cilësisë së ajrit, monitorimin e emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme dhe verifikimin e sistemit matës për matjen e vazhdueshme të emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme;</p> <p>1.3. personi juridik i cili kryen veprimtarinë e sigurimit të cilësisë së matjeve dhe të dhënave të cilësisë së ajrit;</p> <p>1.4. personi, fizik ose juridik – operatori i cili punon me substancat e kontrolluara dhe ose me gazrat serrë të fluorizuara;</p> <p>1.5. personi juridik ose fizik - operatori i impiantit.</p>	<p>1.1. pollutant;</p> <p>1.2. the legal entity that performs the activity of monitoring the air quality, monitoring the emissions of pollutants from stationary sources and verifying the metering system for continuous measurement of pollutants emissions from stationary sources;</p> <p>1.3. the legal entity that performs the activity of quality assurance of air quality measurements and data;</p> <p>1.4. natural or legal person - the operator who works with controlled substances and or with fluorinated greenhouse gases;</p> <p>1.5. legal or natural person - plant operator.</p>	<p>1.1. zagađivač;</p> <p>1.2. pravno lice koje obavlja delatnost praćenja kvaliteta vazduha, praćenja emisija zagađujućih materija iz stacionarnih izvora i verifikacije mernog sistema za kontinuirano merenje emisija zagađujućih materija iz stacionarnih izvora;</p> <p>1.3. pravno lice koje obavlja delatnost osiguranja kvaliteta merenja i podataka kvaliteta vazduha;</p> <p>1.4. fizičko ili pravno lice koje radi sa kontrolisanim supstancama i ili sa fluorisanim gasovima sa efektom staklene bašte;</p> <p>1.5. personi juridik ose fizik - operatori i impiantit</p>
<p style="text-align: center;">Neni 52 Autorizimet e inspektorit mjedisor</p>	<p style="text-align: center;">Article 52 Authorizations of the environmental inspector</p>	<p style="text-align: center;">Član 52 Ovlašćenja inspektora zaštite životne sredine</p>
<p>1. Në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori mjedisor është i autorizuar dhe ka të drejtë qasje në aktet e përgjithshme dhe të veçanta, monitoron kushtet dhe mënyrën e punës së personave të mbikëqyrur dhe ndërmer masat e parashikuara me këtë ligj</p>	<p>1. In conducting the inspection supervision, the environmental inspector is authorized and has the right to access general and special acts, monitors the conditions and manner of work of supervised persons and undertakes the measures provided by this law and other bylaws, in order</p>	<p>1. U vršenju inspeksijskog nadzora inspektor zaštite životne sredine je ovlašćen i ima pravo pristupa opštim i posebnim aktima, prati uslove i način rada nadziranih lica i preuzima mere predviđene ovim zakonom i drugim pravnim aktima da postojeće stanje je</p>

<p>dhe aktet tjera ligjore që gjendja ekzistuese të jetë në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore që dalin nga ky ligj.</p> <p>2. Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese inspektori mjedisor kontrollon:</p> <p>2.1. burimet e palëvizshme të ndotjes së ajrit;</p> <p>2.2. rregullsinë e monitorimit të emisioneve nga burimet palëvizshme të ndotjes së ajrit dhe operatorëve;</p> <p>2.3. punën e pajisjeve për zvogëlimin e emisioneve;</p> <p>2.4. mbajtjen e evidencës për matjet e kryera me të dhëna për vend matjet dhe rezultatet e matjeve, për përdorimin e karburanteve dhe mbeturinave gjatë djegies dhe prezantimin e të dhënave për cilësinë e ajrit dhe emisioneve nga burimet palëvizshme;</p> <p>2.5. zbatimin e obligimeve të parapara me këtë ligj;</p> <p>2.6. zbatimin e dispozitave nga neni 27 dhe 28 të këtij ligji;</p>	<p>that the existing situation to be in accordance with this law and sub-legal acts arising from this law.</p> <p>2. During implementation of the inspection supervision, the environmental inspector controls as follows:</p> <p>2.1. stationary sources of air pollution;</p> <p>2.2. regularity of monitoring emissions from stationary sources of air pollution and operators;</p> <p>2.3. operation of equipment's for emission reduction;</p> <p>2.4. keeping records of measurements performed with data on metering sites and measurement results, on the use of fuels and waste during combustion and presentation of data on air quality and emissions from stationary sources;</p> <p>2.5. implementation of the obligations provided by this law;</p> <p>2.6. implementation of the provisions of Article 27 and 28 of this law;</p>	<p>u skladu sa ovim zakonom i podzakonskim aktima koji proizilaze iz ovog zakona.</p> <p>2. Tokom vršenja inspekcijskog nadzora inspektor kontroliše:</p> <p>2.1. nepokretne izvore zagađenja vazduha;</p> <p>2.2. redovitost praćenja emisija iz nepoketnih izvora zagađenja i operatera;</p> <p>2.3. rad uređaja za smanjenje emisija;</p> <p>2.4. vođenje evidencija o obavljenim merenjima s podacima o mernim mestima i rezultatima merenja, o upotrebljenom gorivu i otpadu prilikom suspaljivanja i dostavljanje podataka o kvalitetu vazduha i emisijama iz nepokretnih izvora;</p> <p>2.5. sprovođenje obaveza predviđenih ovim Zakonom;</p> <p>2.6. sprovođenje akcionih planova iz člana 27. i 28. ovoga Zakona;</p>
---	--	---

<p>2.7. zbatimin e dispozitave nga neni 29 të këtij ligji;</p> <p>2.8. përcjelljen e cilësisë së ajrit në stacionet për monitorimin e përhershëm të cilësisë së ajrit;</p> <p>2.9. zbatimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të përcaktuara në vendimin e Pëlqimit Mjedisor, Lejes Mjedisore dhe Lejes Mjedisore të Integruar;</p> <p>2.10. zbatimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të përcaktuara në vendimin e Lejes Mjedisore Komunale;</p> <p>2.11. zbatimin e matjeve të cilësisë së ajrit nga neni 20 paragrafi 1 të këtij ligji;</p> <p>2.12. veprimet me substancat e kontrolluara dhe gazrat serrë të fluoruara dhe shpenzimin e tyre;</p> <p>2.13. veprimet me produkte që përmbajnë substancat e kontrolluara dhe gazrat serrë të fluoruara ose varen nga ato;</p> <p>2.14. veprimin me substanca të kontrolluara dhe gazrat serrë të fluoruara, pas ndalimit të përdorimit të produkteve të cilat i përmbajnë ato, mënyrën e</p>	<p>2.7. implementation of the provisions of Article 29 of this law;</p> <p>2.8. air quality monitoring in stations for permanent monitoring of air quality;</p> <p>2.9. implementation of air quality protection measures set out in the decision on Environmental Consent, Environmental Permit and Integrated Environmental Permit;</p> <p>2.10. implementation of measures for air quality protection defined in the decision of the Municipal Environmental Permit;</p> <p>2.11. implementation of air quality measurements from Article 20 paragraph 1 of this law;</p> <p>2.12. operations by the controlled substances and fluorinated greenhouse gases and their consumption;</p> <p>2.13. dealing with or dependent on products containing controlled substances and fluorinated greenhouse gases;</p> <p>2.14. treatment with controlled substances and fluorinated greenhouse gases, after use prohibition of products containing them, the manner of collection, use and permanent storage of these substances;</p>	<p>2.7. sprovođenje kratkoročnih akcionih planova iz člana 29. ovoga Zakona;</p> <p>2.8. praćenje kvaliteta vazduha u stanicama za trajno praćenje kvaliteta vazduha;</p> <p>2.9. sprovođenje mera zaštite kvaliteta vazduha utvrđenih rešenjem Ekološke Dozvole, Dozvole Sredine i Integrisane Dozvole Sredine;</p> <p>2.10. sprovođenje mera za zaštitu kvaliteta vazduha definisanih odlukom Opštinske ekološke dozvole;</p> <p>2.11. sprovođenje merenja kvaliteta vazduha iz člana 20. stav 1. ovog zakona;</p> <p>2.12. postupanje s kontrolisanim materijama i fluoriranim stakleničkim gasovima i njihovu potrošnju;</p> <p>2.13. postupanja s proizvodima koji sadrže kontrolisane materije i fluorirane stakleničke gasove ili zavise od njih;</p> <p>2.14. postupanje s kontrolisanim materijama i fluoriranim stakleničkim gasovima nakon prestanka upotrebe proizvoda koji ih sadrži, način</p>
--	---	--

<p>mbledhjes, përdorimit dhe deponimit të përhershëm të këtyre materieve;</p> <p>2.15. kryerjen e aktivitetit të përcjelljes së cilësisë së ajrit, përcjelljes së emisioneve të materieve ndotëse nga burimet e palëvizshme, vërtetimin e saktësisë së instrumenteve matëse për matje kontinuale të emisioneve të materieve ndotëse nga këto burime;</p> <p>2.16. kryerjen e aktiviteteve për sigurimin e cilësisë së matjeve dhe të dhënave për cilësinë e ajrit;</p> <p>2.17. kryerjen e aktiviteteve të mbledhjes, verifikimit të shkarkimeve, montimit, mirëmbajtjes apo servisimit të pajisjeve ftohëse dhe pajisjeve për klimatizim, të pajisjeve kundër zjarrit dhe aparateve për shuarjen e zjarrit, të cilat përmbajnë substancat e kontrolluara dhe gazra serrë të fluoruara ose varen nga ato;</p> <p>2.18. zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së ajrit.</p> <p>3. Inspektori në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas këtij ligji është i autorizuar:</p>	<p>2.15. performing the activity of monitoring the air quality, monitoring the emissions of pollutants from stationary sources, verifying the accuracy of measuring instruments for continuous measurement of pollutants emissions from these sources;</p> <p>2.16. carrying out activities to ensure the quality of measurements and data on air quality;</p> <p>2.17. performing the activities of collecting, discharging, assembling, maintaining or servicing refrigeration and air-conditioning equipment, fire-fighting equipment and fire-fighting apparatus containing controlled substances and fluorinated greenhouse gases, or dependent on those;</p> <p>2.18. implementation of international agreements in the field of air protection.</p> <p>3. The inspector in the exercise of duties and responsibilities according to this law is authorized to:</p>	<p>prikupljanja, upotrebe i trajnog zbrinjavanja tih materija;</p> <p>2.15. obavljanje poslova praćenja kvaliteta vazduha, praćenja emisija zagađujućih materija iz nepokretnih izvora, proveru ispravnosti sistema merenja za kontinualno merenje emisija zagađujućih materija iz ovih izvora;</p> <p>2.16. obavljanje delatnosti za obezbeđivanje kvaliteta merenja i podataka o kvalitetu vazduha;</p> <p>2.17. obavljanje poslova prikupljanja, provere ispusta, ugradnje, održavanja ili servisiranja rashladnih i klimatizacijskih uređaja i protiv požarnih uređaja i aparata za gašenje požara, koji sadrže kontrolirane materije i fluorirane stakleničke gasove ili zavise od njih;</p> <p>2.18. sprovođenje međunarodnih ugovora iz područja zaštite vazduha.</p> <p>3. Inspektor u vršenju dužnosti i odgovornosti prema ovom zakonu je ovlašćen:</p>
--	---	---

<p>3.1. të shqiptoj gjobë me të holla në vend ngjarje, sipas këtij ligji apo ligjeve përkatëse në fuqi;</p> <p>3.2. të inicioj procedurë kundervajtëse dhe penale për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji ndaj personave fizik dhe juridik;</p> <p>3.3. të ndërmarr masa tjera për të cilat është i autorizuar me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 53 Të drejta dhe detyrat e inspektorit mjedisor</p> <p>1. Në zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, në rastin e moszbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala nga ky ligj, inspektori mjedisor ka të drejtë dhe detyrë që personit të mbikëqyrur, me vendim, t'i caktoj afat për përmbushjen e masave për:</p> <p>1.1. eliminimin e mangësive;</p> <p>1.2. eliminimin e parregullsive gjatë veprimit;</p> <p>1.3. ndalimin e kryerjes së aktiviteteve, në procesin e prodhimit;</p>	<p>3.1. to impose a fine on the spot, according to this law or relevant laws in force;</p> <p>3.2. to initiate misdemeanor and criminal proceedings against natural and legal persons, due to violation of the provisions of this law;</p> <p>3.3. to take other measures for which it is authorized by this law and other laws in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 53 Rights and duties of the environmental inspector</p> <p>1. During the implementation of inspection supervision, in case of non-implementation of this law and bylaws issued by this law, the environmental inspector has the right and duty to set a deadline for the supervised person to fulfill the measures for:</p> <p>1.1. elimination of deficiencies;</p> <p>1.2. elimination of irregularities during the action;</p> <p>1.3. prohibition of conducting activities in the manufacturing process;</p>	<p>3.1. da izrekne novčanu kaznu na licu mesta, u skladu sa ovim zakonom ili relevantnim zakonima na snazi;</p> <p>3.2. da pokrene prekršajni i krivični postupak zbog kršenja odredbi ovog zakona protiv fizičkih i pravnih lica;</p> <p>3.3. da preduzme druge mere za koje je ovlašćeno ovim zakonom i drugim zakonima na snazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 53 Prava i dužnosti inspektora zaštite životne sredine</p> <p>1. U sprovođenju inspeksijskog nadzora, u slučaju nespovođenja ovoga Zakona i/ ili podzakonskih akata donesenih na osnovu ovog Zakona, inspektor ima pravo i obvezu da nadziranoj osobi rješenjem odrediti rok o ispunjenju sledećih mera:</p> <p>1.1. otklanjanje nedostataka;</p> <p>1.2. otklanjanje nezakonitosti u toku rada;</p> <p>1.3. zabranu obavljanja radnji u proizvodnom postupku;</p>
---	---	--

<p>1.4. ndalimin e përdorimit të impianteve dhe pajisjeve;</p> <p>1.5. matjen e emisioneve të substancave ndotëse nga burimet e palëvizshme;</p> <p>1.6. ndalimin e përdorimit të impianteve dhe pajisjeve të cilat kanë shkaktuar tejkalimin e vlerave kufitare të emisioneve;</p> <p>1.7. ndalimin e kryerjes së aktiviteteve të monitorimit të cilësisë së ajrit, monitorimin e emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme dhe verifikimin e rregullsisë së pajisjeve për matje kontinuale të emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme;</p> <p>1.8. ndalimin e kryerjes së aktiviteteve të sigurimit të cilësisë së matjeve dhe të dhënave për cilësinë e ajrit;</p> <p>1.9. ndalimin e kryerjes së aktiviteteve të mbledhjes, verifikimit të shkarkimeve, montimit, mirëmbajtjes apo servisimit të pajisjeve ftohëse dhe pajisjeve për klimatizim, të pajisjeve kundër zjarrit dhe aparateve për shuarjen e zjarrit, të cilat përmbajnë materie të kontrolluara dhe gazra serrë të fluoruara ose varen nga ato, riciklimit dhe rikuperimit të substancave të kontrolluara të përdorura dhe gazrave serrë</p>	<p>1.4. prohibition of the use of plants and equipment;</p> <p>1.5. measuring emissions of pollutants from stationary sources;</p> <p>1.6. Prohibition of the use of plants and equipment which have caused exceeding of the emission limit values;</p> <p>1.7. prohibition of performing activities of monitoring air quality, monitoring the emissions of pollutants from stationary sources and verifying the regularity of equipment for continuous measurement of pollutants emissions from stationary sources;</p> <p>1.8. prohibiting the performance of air quality measurement and data quality assurance activities;</p> <p>1.9. Prohibition of collection, discharge verification, installation, maintenance or servicing of refrigeration and air-conditioning equipment's, fire-fighting equipment and fire-fighting apparatus containing controlled substances and fluorinated greenhouse gases, or dependent on them, recycling and recovery of used controlled substances and fluorinated greenhouse gases, if they do not have a</p>	<p>1.4. zabranu upotrebe postrojenja i uređaja;</p> <p>1.5. mjerenje emisija zagađujućih materija iz nepokretnih izvora;</p> <p>1.6. zabranu upotrebe postrojenja i uređaja koji su prouzrokovali prekoračenje granične vrednosti emisija;</p> <p>1.7. zabranu obavljanja poslova praćenja kvaliteta vazduha, praćenja emisija zagađujućih materija iz nepokretnih izvora i proveru ispravnosti mernog sistema za kontinualno mjerenje emisija zagađujućih materija iz nepokretnih izvora;</p> <p>1.8. zabranu obavljanja poslova osiguravanja kvaliteta merenja i podataka kvaliteta vazduha;</p> <p>1.9. zabranu obavljanja poslova prikupljanja, provere propuštanja, ugradnje, održavanja ili servisiranja rashladnih i klimatizacijskih uređaja, protiv požarnih aparata za gašenje požara koji sadrže kontrolisane materije ili fluorirane stakleničke gasove ili zavise od nji, recikliranja i rekuperiranja kontrolisanih upotrebljivih materija i fluoriranih stakleničkih gasova, ako</p>
--	---	---

<p>të fluoruara, nëse nuk kanë leje, gjegjësisht nëse nuk i plotësojnë kushtet e lejes së lëshuar për kryerjen e veprimtarive të tilla;</p> <p>1.10. zbatimin e masave për mbrojtjen e ajrit nga vendimi i Pëlqimit Mjedisor, Lejes Mjedisore, Lejes Mjedisore të Integruar dhe Lejes Mjedisore Komunale;</p> <p>1.11. zbatimin e masave për mbrojtjen e ajrit të dala nga Plani Lokal i Veprimit;</p> <p>1.12. zbatimin e masave për mbrojtjen e ajrit të dala nga Plani Afatshkurtër i Veprimit dhe ndërmarrjen e veprimeve tjera me qëllim të parandalimit të ndotjes së ajrit.</p> <p>2. Inspektori mjedisor me vendim do t'i urdhëroj personit të mbikëqyrur t'i eliminojë parregullsitë në veprimtari në afat të caktuar nëse vërtetohet se:</p> <p>2.1. nuk i mbanë dhe nuk përgatitë regjistrin, evidencat, bilancet, respektivisht nuk bënë plane dhe programe të përcaktuara;</p> <p>2.2. nuk përgatitë raportet, evidencat dhe formularët e përcaktuar;</p>	<p>permit, respectively if they do not meet the conditions of the permit issued for performing such activities;</p> <p>1.10. implementation of air protection measures by the decision of the Environmental Consent, Environmental Permit, Integrated Environmental Permit and Municipal Environmental Permit;</p> <p>1.11. implementation of air protection measures arising from the Local Action Plan;</p> <p>1.12. implementation of air protection measures arising from the Short-Term Action Plan and taking other actions in order to prevent air pollution.</p> <p>2. The environmental inspector will order the supervised person to eliminate the irregularities in the activity, within a certain period of time if it is proven that:</p> <p>2.1. does not keep and does not prepare the register, records, balance sheets, respectively does not make defined plans and programs;</p> <p>2.2. does not prepare the prescribed reports, evidences and forms;</p>	<p>nemaju dozvolu, odnosno ako ne ispunjavaju uslove iz dozvole za obavljanje tih radnji;</p> <p>1.10. za provođenje mera za zaštitu vazduha iz rešenja Ekološke Dozvole, Dozvole Sredine i Integrisane Dozvole Sredine;</p> <p>1.11. provođenje mera za zaštitu vazduha iz lLokalnog Akcionog Plana;</p> <p>1.12. sprovođenje mera za zaštitu vazduha iz kratkoročnog akcionog plana i preduzimanje drugih radnij u svrhu sprečavanja zagađenja vazduha.</p> <p>2. Inspektor će nadziranoj osobi rešenjem narediti otklanjanje nezakonitosti u delatnost u određenom roku ako se utvrdi da:</p> <p>2.1. ne vodi i ne priprema registar, evidencije, bilanse, odnosno ne donosi propisane planove i programe;</p> <p>2.2. ne priprema određene izveštaje, evidencije i obrasce;</p>
--	---	---

<p>2.3. raportet, evidencat, bilancet, formularët dhe të dhënat nga regjistri nuk ia paraqet Ministrisë respektivisht Komunës;</p> <p>2.4. nuk e ka lajmëruar për regjistër, impiantin-pajisjen në të cilin përdoren tretësit organik apo prodhimet të cilat përmbajnë bashkëdyzime organike të avullueshme;</p> <p>2.5. nuk ka paraqitur të dhënat për impiantin/pajisjen e palëvizshëm e cila përmban tre (3) ose më shumë kilogram të substancave të kontrolluara ose gazrave serrë të fluoruar;</p> <p>2.6. nuk është i regjistruar në regjistrin për persona juridik dhe fizik – operator të cilët merren me eksportin dhe importin e materieve të kontrolluara dhe/ose gazrave serë të fluoruara, të cilin e udhëheqë Ministria.</p> <p>2.7. gjatë operimit ka ardhur apo mund të vjen deri te tejkalimi i vlerave kufitare, për të mbrojtur shëndetin e njeriut.</p> <p>3. Inspektori mjedisor me vendim do t'i urdhëroj personit të mbikëqyrur të bëjë matjen e emisioneve të materieve ndotëse nga burimet e palëvizshme:</p>	<p>2.3. reports, records, balance sheets, forms and data from the register are not submitted to the Ministry, respectively the Municipality;</p> <p>2.4. has not notified, or register the plant / device, in which use organic solvents or products containing evaporation organic compounds;</p> <p>2.5. has not submitted data for the stationary plant / equipment which contains three (3) or more kilograms of controlled substances or fluorinated greenhouse gases;</p> <p>2.6. is not registered in the register for legal and natural persons - operators who deal with the export and import of controlled substances and / or fluorinated greenhouse gases, which is managed by the Ministry.</p> <p>2.7. during the operation has come or may come to exceeding's of the limit values, to protect human health.</p> <p>3. The environmental inspector by a decision will order the supervised person, to measure the emissions of pollutants from stationary sources:</p>	<p>2.3. izveštaje, evidencije, bilanse, obrasce i podatke iz registra ne dostavlja Ministarstvu odnosno Opštini;</p> <p>2.4. nije prijavio za registar postrojenja/ uređaj za koje se koriste organski rastvarači ili proizvode koji sadrže isparljiva organska jedinjenja;</p> <p>2.5. nije dostavio podatke za nepokretno postrojenje-uređaj koja sadrži tri (3) ili više kilograma kontrolisane materije ili fluoriranih stakleničkih gasova;</p> <p>2.6. nije upisan u registar javnih ili fizičkih lica – preduzetnika koji se bave sa uvozom i izvozom kontrolisanih materija i/ ili fluoriranih stakleničkih gasova, koje vodi Ministarstvo.</p> <p>2.7. tokom operiranja došlo ili bi moglo doći do prekoračenja graničnih vrednosti, radi zaštite ljudskog zdravlja</p> <p>3. Inspektor zaštite životne sredine će rešenjem naložiti nadziranoj osobi da meri emisije zagađivača iz stacionarnih izvora:</p>
--	--	---

<p>3.1. për të konstatuar shkakun e ndotjes së ajrit;</p> <p>3.2. nëse është ndërruar karburanti;</p> <p>3.3. nëse nuk i ka kryer matjet e përkohshme të emisioneve;</p> <p>3.4. nëse nuk i ka kryer matjet e përkohshme të emisioneve, në afatet e përcaktuara;</p> <p>3.5. nëse nuk i ka kryer matjet nga burimet e palëvizshme të reja ose të riparuar;</p> <p>3.6. nëse konstaton parregullsi në matjet e kryera, e në barrë të personit i cili i ka bërë matjet;</p> <p>3.7. nëse konstaton se matjet i ka bërë personi i cili nuk është i autorizuar/akredituar.</p> <p>3.8. në rast të dyshimit se ka ardhur deri te lëshimi i tepruar i materieve ndotëse në ajër.</p> <p>3.9. zbatimin e matjeve kontinuale të emisioneve të materieve ndotëse nga burimet e palëvizshme, në një afat të caktuar nëse vërteton se ato nuk i zbaton fare ose nuk i zbaton në mënyrën e përcaktuar.</p>	<p>3.1. to ascertain the cause of air pollution;</p> <p>3.2. if the fuel has been changed;</p> <p>3.3. if it has not performed temporary emission measurements;</p> <p>3.4. if he has not performed the temporary emission measurements, within the set deadlines;</p> <p>3.5. if it has not performed measurements from new or repaired stationary sources;</p> <p>3.6. if it finds irregularities in the measurements performed, and at the expense of the person who made the measurements;</p> <p>3.7. if it finds that the measurements were made by a person who is not authorized / accredited.</p> <p>3.8. in case of suspicion that there has been an excessive release of pollutants into the air.</p> <p>3.9. if it proves that: continuous measurements of emissions of pollutants from stationary sources, in a certain term does not apply them at all, or does not apply them in the prescribed manner.</p>	<p>3.1. Radi utvrđivanja uzroka zagađenja vazduha;</p> <p>3.2. ako je gorivo zamenjeno;</p> <p>3.3. ako nije izvršio privremena merenja emisije;</p> <p>3.4. ako nije obavio povremena merenja emisija u propisanim rokovima;</p> <p>3.5. ako nije obavio merenje iz novih ili rekonstruiranih nepokretnih izvora;</p> <p>3.6. ako utvrdi nepravilnosti u obavljenom merenju, a na trošak osobe koja je vršila merenja;</p> <p>3.7. ako utvrdi da je merenje obavio neovlašćena osoba/ ne akreditirana.</p> <p>3.8. u slučaju osnovane sumnje da je došlo do prekomernog ispuštanja zagađujućih materija u vazduh.</p> <p>3.9. provedbu kontinuiranog merenja emisija zagađujućih materija iz nepokretnih izvora u primerenom roku ako utvrdi da ih ne provodi ili ih ne provodi na propisani način.</p>
--	--	--

<p>4. Inspektori mjedisor me vendim do t'i urdhëroj personit të mbikëqyrur zbatimin e masave nga vendimi i Pëlqimit Mjedisor Lejes Mjedisore të Integruar dhe Lejes Mjedisore dhe Lejes Mjedisore Komunale, nëse nuk i zbaton ato.</p> <p>5. Inspektori mjedisor me vendim, do t'i urdhëroj personit të mbikëqyrur ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së monitorimit të cilësisë së ajrit, monitorimit të emisioneve të materieve ndotëse në ajër nga burimet e palëvizshme dhe verifikimit të saktësisë së instrumenteve matëse për matjet kontinuale të emisioneve të materieve ndotëse në ajër, nga burimet e palëvizshme:</p> <p>5.1. nëse nuk është i akredituar;</p> <p>5.2. nëse nuk i plotëson kushtet në bazë të cilave është akredituar, deri në plotësimin e kushteve;</p> <p>5.3. nëse kryen aktivitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit, monitorimit të emisioneve të materieve ndotëse nga burimet e palëvizshme dhe verifikimin e saktësisë së instrumenteve matëse për matjen kontinuale të emisioneve të materieve ndotëse nga burimet e palëvizshme, sipas</p>	<p>4. The environmental inspector by a decision will order the supervised person to implement the measures from the decision of the Environmental Consent, Integrated Environmental Permit and the Environmental Permit and the Municipal Environmental Permit, if he does not implement them.</p> <p>5. The environmental inspector by a decision, will order the supervised person, to stop the exercise of the activity of monitoring the air quality, monitoring the emissions of pollutants in the air from stationary sources and verifying the accuracy of the measuring instruments, for the continuous measurements of emissions of pollutants into the air, from stationary sources:</p> <p>5.1. if not accredited;</p> <p>5.2. if it does not meet the conditions under which it is accredited, until the conditions are met;</p> <p>5.3. if it performs the activities of air quality monitoring, monitoring of emissions of pollutants from stationary sources and verification of the accuracy of measuring instruments for continuous measurement of pollutants emissions from stationary sources, according to the reference method</p>	<p>4. Inspektor rešenjem nalaže nadziranoj osobi sprovođenje mera iz odluke Ekološke Dozvole, odnosno Dozvole Sredine i Integrisane Dozvole Sredine, ako iste ne sprovodi.</p> <p>5. Inspektor će nadziranoj osobi rešenjem narediti zabranu obavljanja delatnosti praćenja kvaliteta vazduha, praćenje emisija zagađujućih materija iz nepokretnih izvora i provere ispravnosti mernog sistema za kontinualno merenje emisija zagađujućih materija u vazduhu iz nepokretnih izvora:</p> <p>5.1. ako nije akreditiran;</p> <p>5.2. ako ne ispunjava uslove na temelju kojih je akreditiran, do ispunjavanja uslova;</p> <p>5.3. ako obavlja delatnosti praćenja kvaliteta vazduha, praćenja emisija zagađujućih materija iz nepokretnih izvora i provere ispravnosti mernih instrumenata za kontinualno merenje emisija zagađujućih materija iz nepokretnih izvora</p>
---	---	--

